



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:175501

Datë: 18.01.2022

Numri i dokumentit: 02617526

**Pkr.nr.101/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët Xheladin Osmani dhe Luan Berisha me proçesmbajtësen Birsën Kume, në çështjen penale kundër të akuzuarit P.M., nga fshati ....., Komuna e ....., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KP, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.3 -1 të KP, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KP dhe veprës penale asgjësimi apo i dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KP, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamentit për Krime të Rënda, PP/I.nr. 171/2021 të datës 20.08.2021, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore me datë 03.09.2021, 05.10.2021, 22.11.2021, 30.12.2021, pa prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.S.S., më datën 06.01.2022, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I akuzuari:**

**P.M., nga** i ati .....dhe e ëma .....e lindur ....., i lindur me .....në fshatin ....., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer sh kollën e mesme, me profesion punëtor, i martuar, i ati i një fëmiu, i gjendjes së dobët ekonomike, shqipëtar shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në paraburgim prej datës 07.08.2021 gjerr më 30.12.2021.

Konform nenit 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPP i akuzuari P.M.,

## **LIROHET NGA AKUZA**

1.Se me datën 07.08.2021 rreth orës 10,00 në fshatin .....Komuna e Suharekës tenton ta privon nga jeta të dëmtuarin N.M., me të cilin kishte një mosmarrëveshje të mëhershme lidhur me një shitëblerje të një paluajtshmërie, në atë mënyrë që po sa e sheh të dëmtuarin duke

e drejtuar kamionin e markës “MAN” me targa të rregjistrimit ....., nga rruga lokale e fshatit Gjinovc, për tu kyçur në rrugën magjistrale Suharekë- Prizren, gjuan me gurë në pjesën e përparme të xhamit të kamionit të cilin e dëmton duke e thyer, meqenëse i dëmtuari nuk ndalet i akuzuari vrapon në këmbë pas tij rreth 200 metra dhe nga prapa me armën automatike të prodhimit Kinez 7.65 mm, gjuan 6 herë në drejtim të dëmtuarit.

**-Këso dore kishte për të kryer veprën penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KP.**

Konform nenit 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP ndaj të akuzuarit P.M.,

## **REFUZOHET AKUZA**

2.Se me datë kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin nën I me armë – mjet të rrezikshëm shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve, në vendin ku janë të pranishëm një numër i madh i njerëzve dhe automjeteve në rrugën lokale në fshatin Gjinovc në afërsi të kyqjes në rrugën magjistrale Suharekë-Prizren, ashtu që shtënë me armë 6 herë në drejtim të dëmtuarit NM., duke rrezikuar edhe jetën e njerëzve të tjerë të pranishëm në vendin ku ka ndodhur ngjarja.

**-Këso dore kishte për të kryer veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 3 -1 të KP.**

**I. I akuzuari P.M.,**

## **ËSHTË FAJTOR**

1.Se me datën 07.08.2021 rreth orës 10:00 minuta, në fshatin Gjinovc Komuna e Suharekës, posa e shih të dëmtuarin N.M., duke e drejtuar kamionin e markës “.....”me targa të rregjistrimit .....nga rruga lokale e fshatit Gjinovc, për tu kyçur në rrugën magjistrale Suharekë-Prizren, gjuan me gurë në pjesën e përparme të xhamit të kamionit të cilin e dëmton duke e thyer, e pastaj vrapon në këmbë pas të dëmtuarit rreth 200 metra dhe nga prapa përdor armën automatike të prodhimit Kinez të kalibrit 7.65 mm, me qëllim kërcënimi dhe frikësimi duke gjuajtur në ajër.

**-Këso dore ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 2 të KP.**

2.Se me datën 07.08.2021 rreth orës 10,00 në fshatin Gjinovc mbanë në posedim armën automatike të prodhimit Kinez me numër serik 210 7272 të kalibrit 7.65 mm, vitit të prodhimit 1954 si dhe një karikator me 12 fishek të kalibrit 7.65 mm dhe një pushkë të improvizuar nga druri në formë të pushkës automatike me ngjyrë të zezë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

**-Këso dore ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KP.**

3.Me datën 07.08.2021 rreth orës 10,20 minuta dëmton apo e bënë të papërdorshme pasurinë e të dëmtuarit N.M., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me një shitëblerje të paluajtshmërisë me të dëmtuarin, derisa i dëmtuari ishte duke u kyçur nga rruga lokale e fshatit Gjinovc për në rrugën kryesore Suharekë-Prizren, i pandehuri me një gurë e godet xhamin e përparmë të automjetit të markës “.....” me targa të rregjistrimit ....., duke i shkaktuar dëm material.

**-Këso dore ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KP.**

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të nenit 7,8, 9, 10, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, ,76, paragrafi 2 nënparagrafi 2.4, 79 të KP, e në lidhje me nenin 375 par. 2, 366 par.1 dhe 321 paragrafi 1 të KP, e

**G J Y K O N**

I.Për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 paragrafi 2 të KP me dënim **me gjobë në shumën prej 1200 (njëmijëedyqind) euro**, si dhe me dënim **me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti**, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 07.08.2021 gjerr më 30.12.2021, gjithsejt 146 ditë.

II.Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KP-së me dënim **me gjobë në shumën prej 1.400 (njëmijëekatërqind) euro**.

III.Për veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KP-së **me dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) euro**.

Konform nenit 76 paragrafi 2 pika 2.4 të KP gjykata ia shqipton **dënimin unik me gjobë në shumën prej 3.000 (tremijë) euro** të cilin dënim me gjobë është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform nenit 43 paragrafi 3 të KP nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën gjykata mund t ia zëvendsoj dënimin me gjobë me dënim me burgim ashtu që çdo 20 euro gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim.

**I dëmtuari** N.M.,, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil.

Konform nenit 366 par.3 të KP-së nga i akuzuari konfiskohet arma autormatike e prodhimit Kinez me numër serik 2107272 kalibrit 7.65 mm, viti i prodhimit 1954 si dhe një karikator me 12 fishekë të kalibrit 7.65 mm dhe një pushkë e improvizuar nga druri në formë të pushkës automatike me ngjyrë të zezë, si mjete të kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuari që ti paguajë shpenzimet procedurale -paushallin gjyqësor në shumën prej 200 (dyqind) euro si dhe 50 (pesëdhjetë) euro në emër të programit për kompenzimin e viktimave të krimin, në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

## A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti për krime të rënda, kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/I.nr. 171/2021 datë 20.08.2021, kundër të akuzuarit P..... M..... nga fshati Gjinovc Komuna e Suharekës, për shkak të veprave penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KP, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.3 -1 të KP, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KP dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KP.

Me datën 03.09.2021 gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari P..... M..... ka pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KP dhe për veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KP.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura, në fjalën përfundimtare të dhënë me datë 30.12.2021 prokurori i shtetit Mehdi Sefa ka ngelë në tërësi pranë aktakuzës për veprat penale të përshkruara si në dispozitivet prej I – IV të aktakuzës, duke cekur se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, lista e armës së konfiskuar, foto dokumentacioni i teknikës kriminalistike nga vendi i ngjarjes, nga kamerat e sigurisë të përmbledhura në video inçizimin dhe CD-ja nga vendi i ngjarjes, shihet se i akuzuari P..... M..... ka shtënë me armë, sipas deklaratës së të dëmtuarit N.....M..... në drejtimin e tij dhe shihet se ka qenë ditë me frekuentim të madhe të njerëzve dhe automjeteve në rrugën magjistrale. Sipas deklaratës së të dëmtuarit-dëshmitarit N.....M..... në asnjë moment ai nuk e ka provokuar këtu të akuzuarin P..... M....., ka qenë duke ecur në rrugë në drejtimin e tij dhe se nuk ka patur asgjë në dorë me të cilin kishte me rrezikuar sigurinë e këtu të akuzuarit. I akuzuari pa kurrfarë arsye e godet me gurë xhamin e përparmë të kamionit të cilin e drejtonte N.....M..... e që pastaj hyn në parcelën e tij në një shtëpizë, merr armën automatike të prodhimit Kinez 7.65 mm duke tentuar me dashje ta privoj nga jeta të dëmtuarin N.....M....., duke shtënë 6 herë me armë. Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga video inçizimi, nga kamerat në vendin e ngjarjes, kështu që kërkon nga gjykata që të njejtin ta shpall fajtor për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KP dhe veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 KP, pasi që me armë-mjet të rrezikshëm ka shkaktuar rrezik të madhë për jetën e njerëzve dhe për kalimtarët. Duke marr parasysh pranimin e fajësisë i njëjti të shpallet fajtor edhe për veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 dhe veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KP. Si dënim plotësues ka propozuar që të konfiskohet arma si në propozim të aktakuzës.

Mbrojtësja e të akuzuarit P..... M....., avokat S.S., fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar në formën e shkruar dhe se gjatë elaborimit verbal ka theksuar se nuk është vërtetuar dashja si element subjektiv i veprës penale nga pika I e aktakuzës. As vepra penale shkaktimi i rrezikshëm të përgjithshëm nuk është argumentuar nga prokuroria e që është vërtetuar edhe nga vetë i dëmtuari i cili theksoi se vendi ku ndodhi incidenti nuk ishte i frekuentuar me njerëz, andaj ka propozuar që trupi gjykues në mungesë të provave të akuzuarin P..... M..... ta liron nga akuza për pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës, ndërsa ta shpall fajtor për pikën III dhe IV, për veprat penale për të cilat e ka pranuar fajësinë dhe si rrethana lehtësuese të merr parasysh pendimin, mbajtjen e tij në paraburgim që ka ndikuar tek i njëjti që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla apo të ngjashme si dhe faktin se të dëmtuarit do t ia kompenzon dëmin.

I akuzuari P..... M..... është pajtuar me pohimet e mbrojtëses duke shtuar se dënimi i personit në mungesë të provave është shkelje e të drejtave të njeriut.

Në rastin konkret për gjykatën nuk ka qenë kontestuese dispozitivi III dhe IV i aktakuzës, vepra penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KP dhe vepra penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KP, për të cilat vepra penale i akuzuari edhe e ka pranuar fajësinë. Mirëpo, kontestuese ka qenë fakti se këtu i akuzuari a ka vepruar me dashje dhe se a ka qenë qëllimi i tij që ta privon nga jeta këtu të dëmtuarin N.M., ,respektivisht cilat janë veprimet inkriminuese të akuzuarit P..... M..... me të cilat veprime do të formoheshin edhe elementet esenciale të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KP dhe veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.3 – 1 të KP,e që i vihen në barrë sipas dispozitivit nën I dhe II të aktakuzës.

Andaj,në këtë drejtim gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje gjatë shqyrtimit të datës 22.11.2021 ka ndërguar në cilësi të dëshmitarit të dëmtuarin N.....M....., i cili në fillim ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratës së dhënë në prokurorinë e shtetit me datën 12.08.2021 dhe se gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se më herët nuk ka patur ndonjë mosmarrëveshje me të akuzuarin P..... M..... Ditën kritike ka qenë me kamionin e tij duke u kyqur në rrugën Suharekë-Prizren nga fshati Gjinovc dhe me tu kyqur në rrugën kryesore në drejtim të Prizrenit diku përafërsisht pas nja 100 metra është punishtja e P..... M.....t dhe se prej aty ai e ka gjuajtur me guri duke ia thyerr shofershajbnën e kamionit. Distanca kur e ka gjuajtur me gurë ka qenë diku rreth 5-6 metra dhe se cila ka qenë arsyeja nuk e din. Pas kësaj është larguar prej rrugës kryesore dhe e ka ndalur kamionin dhe atje e ka pa P..... M..... duke nxjerr nga automjeti i vet armën,e që ka qenë një armë e gjatë dhe se në atë moment distanca ka qenë 7-10 metra aq sa i ka ndarë rruga. Pasiqë e ka nxjerr armën ka vrapuar në drejtim të tij, mirëpo i dëmtuari ka filluar që të lëviz në drejtim të Prizrenit me automjet dhe në pasqyre ka vërejtur të akuzuarin duke vrapuar me armë në dorë, ka shtënë në drejtim të tij, mirëpo asnjë predhë nuk e ka goditur kamionin e tij. Mendon se qëllimi i të akuzuarit ka qenë që ta privon nga jeta. Në momentin kur e ka gjuajtur me armë i akuzuari ka qenë në këmbë, ndërsa i dëmtuari ka lëvizuar me një shpejtësi prej 20 km/h, dhe se distanca në mes tyre ka qenë diku rreth 30 metra.

Gjatë shqyrtimit të datës 22.11.2021 gjykata ka administruar edhe provat materiale,ka bërë shiqimin në listën e armëve të konfiskuara me nr.2021-GB-552 datë 07.08.2021,nga e cila u vërtetua se me datën e cekur është konfiskuar pushka automatike e prodhimit Kinez kalibrit 7.65 mm, së bashku me karikatorin dhe një pushkë e improvizuar nga druri në formë të pushkës automatike me ngjyrë të zezë.

Nga fotodokumentacioni i Drejtorisë së teknikës kriminalistike me numër të dosjes HS-TK-193/2021 vërtetohet- shihen pamjet e pushkës automatike me karikator, në foton nr.8 shihen fishekët e kal.7.65 mm që kanë qenë të vendosura në karikator, në foton nr.10 shihet vendi i ngjarjes në fshatin Gjinovc në magjistralen Suharekë-Prizren, në anën e djathtë, foto nr.11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 paraqesin gëzhojat e evidentuara në vendin e ngjarjes. Në foton nr.1 shihet kamioni me targa 04-406-AG ndërsa në foton 2.shihet parafongo e kamionit që është dëmtuar me ndonjë mjet të fortë.

Nga video inqizimi,CD-ja e shiquar gjatë shqyrtimit gjyqësor i cili video inqizim zgjat 55 sekonda, në sekondën 00:17 shihet i akuzuari kur del prej punishtes së vet dhe vazhdon

rrugës te poshtë, ndërsa në sekondën 00:27 shihet kur i njëjti fillon që të gjuaj me pushkë në ajër, e që pastaj kthehet përsëri në drejtim të punishtes.

Gjatë shqyrtimit të datës 30.12.2021 mbrojtjen e vet e ka dhënë i akuzuari P..... M..... i cili në mes tjerash ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë deklaratave të dhëna me datë 08.08.2021 në stacionin policor në Suharekë si dhe në deklaratën e dhënë në prokurorinë e shtetit në Prizren me datë 12.08.2021. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës së lartëcekur ka deklaruar se nuk ka patur më herët ndonjë mosmarrëveshje me N.....M....., mirëpo qëndron fakti se N.....M..... çdo herë kur janë takuar e ka provokuar pa asnjë shkak. Provokimi ka qenë në atë mënyrë që një herë e ka ndalë kamionetën e tij para automjetit të tij –të akuzuarit duke ia pamundësuar kalimin dhe se ditën kritike rasti ka ndodh në afekt , pasiqë e ka ndalur i dëmtuari kamionin para pronës së tij, ku i akuzuari ka qenë jashtë pronës-jashtë rrethojave duke punuar diçka dhe se i dëmtuari me atë rast i ka bo me gisht, e ka sha, ia ka sha nanën dhe e ka provokuar. I akuzuari i ka thënë që të largohet nga prona e tij, mirëpo i dëmtuari ia ka bo me gisht dhe e ka shajt duke i thënë:” hajt morr se ta q...nanën” . Në atë moment nuk e ka patur armën por ka qenë i frikësuar, i flustruar, ka qenë nën afekt dhe i traumatizuar. Së pari ka gjuajtur me gurë në drejtim të kamionit deri sa ka qenë kamioni i ndalur, mirëpo pas një minuti kur kamioni ka vazhduar rrugën në drejtim të Prizrenit dhe diku pas 50 metra është ndalur, pastaj e ka marr armën nga zyra që ndodhet në punishten e tij dhe ka ecur pas kamionit dhe ka gjuajtur 2-3 herë dhe ate ka gjujtur në ajër, nga frika.

Në bazë të provave të lartëcekura pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit P.M., nuk formohen elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KP nga fakti se kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë bindëse dhe relevante. Përkundër faktit që i dëmtuari N.M., ka deklaruar në cilësi të dëshmitarit se mendon që qëllimi i të akuzuarit ka qenë që ta privon nga jeta, se në pasqyre ka vërejtur të akuzuarin duke vrapuar me armë në dorë dhe ka shtënë në drejtim të tij, mirëpo asnjë predhë nuk e ka goditur kamionin e tij dhe se në momentin kur e ka gjuajtur me armë i akuzuari ka qenë në këmbë, ndërsa i dëmtuari ka lëvizuar me një shpejtësi prej 20 km/h, dhe se distanca në mes tyre ka qenë diku rreth 30 metra, kjo deklaratë e dëshmitarit për gjykatën është jo e besueshme dhe në kundërshtim me provat tjera, e sidomos me provën materiale, videoinqizimin nga vendi i ngjarjes, ku shihet se me të vërtetë i akuzuari vrapon me armë në dorë në drejtim të lëvizjes së kamionit të dëmtuarit, mirëpo në bazë të inqizimit vërtetohet se ai gjuan me armë në ajër e jo në drejtim të dëmtuarit.

Poashtu deklarata e tij është në kundërshtim edhe me mbrojtjen e të akuzuarit P.M., i cili në mbrojtjen e vet nuk e mohoi faktin se së pari ka gjuajtur me gurë në drejtim të kamionit derisa ka qenë kamioni i ndalur, e që pastaj e ka marr armën nga zyra që ndodhet në punishten e tij dhe ka ecur pas kamionit dhe ka gjuajtur 2-3 herë dhe ate ka gjuajtur në ajër, nga frika. Gjykata vlerësoi dhe me kujdes analizo i edhe mbrojtjen e të akuzuarit e cila është në harmoni dhe përputhje edhe me provat materiale, CD e shiquar gjatë shqyrtimit gjyqësor ku vërtetohet fakti se i njëjti në sekondën 00:17 del prej punishtes dhe vazhdon rrugës te poshtë, ndërsa në sekondën 00:27 i njëjti fillon që të gjuaj me pushkë në ajër, e që pastaj kthehet përsëri në drejtim të punishtes. Në këtë drejtim, mbrojtja e të akuzuarit e paraqitur në shqyrtim gjyqësor ishte e qartë, koncize, e plotë dhe pa ndonjë kontradiktë brenda saj dhe kësisoji, gjykata vendosi që të njëjtës t'i besoj plotësisht, për shkaqet dhe arsyet e theksuara më lartë, duke mos ia falur besimin deklaratës së të dëmtuarit, e cila deklaratë ishte në kundërshtim me provën materiale-CD-në dhe mbrojtjen e të akuzuarit rreth faktit se në çfarë drejtimi ka gjuajtur i akuzuari.

Gjykata poashtu nuk ia fali besimin pjesës së deklaratës së të dëmtuarit N.M., ,i cili në deklaratë ka pohuar se derisa ishte duke u kyqur në rrugën kryesore në drejtim të Prizrenit diku për afërsisht pas nja 100 metra është punishtja e P..... M.....t dhe se prej aty ai e ka gjuajtur me guri duke ia thyerr shofershajbnën e kamionit dhe se distanca kur e ka gjuajtur me gurë ka qenë diku rreth 5-6 metra. Kjo nga fakti se do të ishte e pamundur që i akuzuari ta vërente të dëmtuarin duke qarkulluar me automjet dhe të ketë kohë pastaj që ta gjuan me gur.Por sipas bindjes së gjykatës i dëmtuari vet është ndalur para punishtes së të akuzuarit dhe e ka provokuar e që pastaj i akuzuari ka gjuajtur me gur në drejtim të kamionit të tij.Andaj,bazuar në këtë fakt gjykata edhe ia fali besimin deklaratës së të akuzuarit,kur ka deklaruar se pasiqë e ka ndalur i dëmtuari kamionin para pronës së tij, ku i akuzuari ka qenë jashtë pronës-jashtë rrethojave duke punuar diçka dhe se i dëmtuari me atë rast i ka bo me gisht, e ka sha, ia ka sha nanën dhe e ka provokuar.

Gjykata pasi që analizoi provat veç e veç dhe të gjitha në ndërlidhje, gjeti se nuk është arritur të provohet se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale vrasja në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 KP-së. Kjo nga fakti se sipas qëndrimit dhe bindjes së gjykatës, nuk është vërtetuar se ditën kritike, i akuzuari me dashje të ketë tentuar të privon nga jeta të dëmtuarin N.....M.....Andaj, pasi që nga provat e administruara, sipas qëndrimit dhe vlerësimit të gjykatës, nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprime që lidhen me elementet dhe figurën e veprës penale vrasja në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 20 të KP-së, në drejtim të tij, gjykata në P..... me dispozitat e KPP-së, ka shqiptuar aktgjykim lirues.

Për të konsideruar fajtor për veprën penale të vrasjes në tentativë duhet që vepra të kryhet me dashje, e që në rastin konkret prokurori nuk ka arritur që këtë ta vërtetoj me asnjë provë. Përveç deklaratës së të dëmtuarit që deklaroi se i akuzuari ka patur për qëllim që ta privoj nga jeta, me provat materiale dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit u vërtetua e kundërta, se ai ka gjuajtur në ajër. Kjo nënkupton se qëllimi i tij nuk ka qenë privimi i të dëmtuarit nga jeta, se në veprimet e tij nuk ka ekzistuar dashja-direkte apo eventuale që ta privoj nga jeta të dëmtuarin. Andaj, në mungesë të provave që do ta vërtetonin faktin e fajësisë, pasiqë një gjë e tillë nuk është provuar me asnjë provë relevante dhe bindëse, gjykata morri aktgjykim lirues dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, sepse nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale për të cilën është akuzuar në bazë të aktakuzës,si në pikën I .

Me aktakuzë nën pikën II, prokuroria e ka akuzuar të akuzuarin P.M., për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 3 -1 të KP.Për të ekzistuar kjo vepër penale duhet që të shkaktohet rrezik i madh për jetën e njerëzve apo dëm i konsiderueshëm material,apo sipas nenit 3 të dispozitës 356 të KP,vepra penale të kryhet në vendin ku janë të pranishëm një numër i madh i njerëzve.Në rastin konkret nuk kemi asnjë prej këtyre elementeve esenciale të kësaj vepre penale,nuk është shkaktuar rrezik i madh për jetën e njerëzve apo dëm i konsiderueshëm material,nga fakti se në rrugë përpos automjeteve që kanë qarkulluar nuk ka patur njerëz.Ky fakt u vërtetua nga video-inqizimi i vendit të ngjarjes.Poashtu nuk është shkaktuar asnjë dëm i konsiderueshëm pasuror.Përkundrazi,ditën kritike i akuzuari e ka përdorur armën në mënyrë kërcënuese ose frikësuese duke gjuajtur në ajër.

Andaj,bazuar në të lartëcekurat gjykata e refuzoi akuzën,për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 3 -1 të KP, nga fakti se veprimet e kryerjes së

kësaj veprë penale ndërlidhen me veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KP dhe me vet faktin se vepra penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 paragrafi 3 -1 të KP,siç është akuzuar i akuzuari,kjo vepër penale është inkorporuar apo konsumuar në veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KP,pasiqë konform nenit 367 par.2 të KP kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese dënohet me gjobë deri në 10.000 euro dhe me burgim prej 1 deri në 10 vjet.

Në bazë të provave të lartëcekura e të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga deklarata e të akuzuarit, është vërtetuar se i njejtë ditën kritike e ka përdorur armën në mënyrë kërcënuese dhe frikësuese duke gjuajtur në ajër, e që kjo është vërtetuar edhe me video inçizimin nga vendi i ngjarjes për çka edhe gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit janë formuar të gjitha elementet e kësaj veprë penale, pasiqë i akuzuari me datën 07.08.2021 rreth orës 10:00 minuta, në fshatin Gjinovc Komuna e Suharekës, posa e sheh të dëmtuarin N.....M..... duke e drejtuar kamionin e markës “.....”me targa të regjistrimit .....nga rruga lokale e fshatit Gjinovc, për tu kyçur në rrugën magjistrale Suharekë-Prizren, gjuan me gur në pjesën e përparme të xhamit të kamionit të cilën e dëmton duke e thyer, e pastaj vrapon në këmbë pas të dëmtuarit rreth 200 metra dhe nga prapa përdor armën automatike të prodhimit Kinez të kalibrit 7.65 mm, me qëllim kërcënimi dhe frikësimi duke gjuajtur në ajër.Provat e administruara gjatë shqyrtimit kanë vërtetuar se i njejtë nuk ka dashur dhe nuk ka dëshiruar që ta privoj nga jeta këtu të dëmtuarin por qëllimi i tij ka qenë vetëm frikësimi i të dëmtuarit. I akuzuari P.M., ka vepruar me dashje direkte në kryerjen e veprës penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm, armën e ka patur me veti kur ka shtënë në ajër me qëllim të frikësimit të dëmtuarit e jo me qëllim të privimit të tij nga jeta.

Veprën të cilën e ka kryer i akuzuari P..... M....., shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm-përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm janë kryer brenda një periudhe të njejtë dhe të caktuar kohore dhe se ka ekzistuar vazhdimësia e caktuar kohore. Në rastin konkret nëse dy apo më shumë vepra sajojnë një vazhdim, disa janë forma të lehta apo të rëndomta, ndërsa njëra prej tyre është formë e rëndë, në këto raste duhet konsideruar se është kryer forma e rëndë e veprës penale në vazhdim, e që këtu bëhet fjalë për veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm e cila vepër është më e rëndë se vepra penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm.

Andaj bazuar në të lartëcekurat gjykata gjeti se në rastin konkret i akuzuari është fajtor për veprën penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KP,për çka edhe e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Sa i përket dispozitivit nën III të aktakuzës,duke marr parasysh që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KP,i cili pranimit i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPP i akuzuari ka kupruar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,pranimit i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, pranimit i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike,gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par. 1 të KP,se me datën 07.08.2021 rreth orës 10,00 në fshatin Gjinovc mbanë në posedim armën automatike të prodhimit Kinez me numër serik 210 7272 të kalibrit 7.65 mm, vitit të prodhimit 1954 si dhe një karikator me 12 fishek të kalibrit 7.65



mm dhe një pushkë të improvizuar nga druri në formë të pushkës automatike me ngjyrë të zezë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Poashtu në bazë të pranimit të fajësisë të bërë konform dispozitave të nenit 248 të KPP, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KP, sepse me datën 07.08.2021 rreth orës 10,20 minuta dëmton apo e bënë të papërdorshme pasurinë e të dëmtuarit N.....M..... në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me një shitblerje të paluajtshmërisë me të dëmtuarin, deri sa i dëmtuari ishte duke u kyçur nga rruga lokale e fshatit Gjinovc për në rrugën kryesore Suharekë-Prizren, i pandehuri me një gurë e godet xhamin e përmarmë të automjetit të markës “.....” me targa të regjistrimit ..... duke i shkaktuar dëm material.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në matjen e dënimit, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra penale. Kështu, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për dy vepra penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KP dhe për veprën penale asgjësimi apo dëmtimi I pasurisë nga neni 321 par.1 të KP, rrethanat personale- është i martuar dhe ka një fëmij, i njëjti është i gjendjes të dobët ekonomike, se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, pra i njëjti nuk ka të kaluar kriminale, pasiqë në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë- aktgjykim të plotëfuqishëm që i njëjti është dënuar ndonjëherë për ndonjë vepër penale. Pasiqë rrethanë rënduese nuk gjeti, është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar, do të arrijë qëllimin e tij konform nenit 38 të KPRK-së, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur me dispozita përkatëse ligjore, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se do t'i mundësoj një balancë të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit t'i mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm dhe special parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjukata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht preventivës së posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve e të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit në të gjitha segmentet e tij.

Vendimi për konfiskimin e armëve dhe municionit, është marrë konform nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së lidhur me nenin 282 paragrafi 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, është marrë konformë nenit 450 par.2 pika 2. 6 në lidhje me nenin 453 par.1. të KPP.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit të viktimave të krimit, është marrë në P..... me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Numri i lëndës: 2021:175501  
Datë: 18.01.2022  
Numri i dokumentit: 02617526

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

**2021:175501, 18.01.2022**

**Kryetarja e trupit gjykues  
Ajser Skenderi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.